

V E N D I M
Nr.269, datë 21.9.1995

PËR SHKARKIMIN E KRYETARIT TË GJYKATËS SË KASACIONIT, ZEF BROZI

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr. 7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim Të Presidentit të Republikës,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

1. Të shkarkojë zotin Zef Brozi nga të gjitha funksionet në Gjykatën e Kasacionit për shkak të veprimtarisë së tij antiligjore, antikushtetuese dhe shkeljen e rëndë të lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve, siç del nga vendimi nr.12, datë 21.9.1995 të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka shpallur antiligjore dhe antikushtetuese nxjerjen e urdhrave të përsëritura për pezullimin e të njëjtit vendim civil të formës së prerë të gjykatës nga ana e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, si dhe të pezullimit dhe kundërshtimit të vendimeve të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.